

PROCESVERBAL
nga seanca e 35-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 06.11.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lllazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dogleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 35-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 13:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Ajdini kishte vërejtje lidhur me përkthimin në gjuhën shqipe të propozimit të Rendit të ditës për seancën e 35-të, për të cilin supozoi se bëhet fjalë për gabim teknik. Shpjegoi se në pikën 1, numri "34" duhet të artikulohet dhe të lexohet "34-të".

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 34-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 26.09.2023.
2. Shqyrtimi i Raporteve Tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 korriku deri më 30 shtator 2023.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit VINSAT KABELL nga Vinica, për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 34-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 26.09.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Petrushevski, lidhur me Raportet tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 korriku deri më 30 shtator 2023, sqaroi se Këshilli vetëm i shqyrton dhe nuk i voton, në mënyrë që anëtarët të jenë në rrjedhë me punën e Agjencisë.

Këshilli nuk kishte vërejtje lidhur me përmbajtjen.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit VINSAT KABELL Vinicë, për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se gjatë monitorimi të rregullt programor të kryer më 31.10.2023, është konstatuar se ky operator ritransmeton shërbimin programor “Super RTL” pa u regjistruar paraprakisht në Agjenci. Prandaj propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike për shkak se operatori për herë të parë këtë vit e shkel këtë nen të LSHMAAV dhe urdhërohet që menjëherë pas marrjes së aktvendimit për vërejtje publike që të harmonizojë punën e tij me Ligjin, përkatësisht të ndërpresë transmetimin e shërbimit programor.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-3948/1, datë 31.10.2023 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë Tregtare të Televizionit Kabllor VINSAT KABELL SHPK Vinicë t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022 e detyron që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizojë punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se Shoqëria Tregtare e Televizionit Kabllor VINSAT KABELL SHPK Vinica, e cila sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të ushtrojë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 26.10.2023 për përdoruesit e saj ka ritransmetuar shërbimin programor “Super RTL” i cili nuk mbulohet me çertifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektorit për Çështje Juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit përcaktuar në këtë Aktvendim për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-4035/3

10.11.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**